

KREDIA E GJELBËR FLETË E STANDARTIZUAR E INFORMACIONIT PARAKONTRAKTOR

Zërat	Përshkrimi
Teksti prezantues	Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk përbën detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi.
1. Banka	BANKA KOMBETARE TREGTARE (BKT) SH.A Adresa: Rruga e Vilave, Lundër 1, 1045, Tiranë, Shqipëri Adresa e web-it: www.bkt.com.al Email: info@bkt.com.al Numri i telefonit: 042 266 288
2. Emri i Produktit	Kredi e Gjellbër
3. Lloji i Kredisë	1. Kredi e siguruar me hipotekim pasurie të paluajtshme 2. Kredi Konsumatore e siguruar me dorëzani
4. Qëllimi i produktit	Qëllimi i huasë "Kredia e Gjellbër" është financimi i të gjithë individëve që duan të përdorin kredi për përmirësimin e ambienteve të tyre të jetesës, përmirësim që do të çojë në kursimin e energjisë dhe reduktimin e emetimeve të CO2.
5. Përshkrimi i produktit	<p>Projektet e konsumatorëve që mund të financohen sipas kësaj kredie janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Ndërrimi i sistemeve të furnizimit me ngrohje (zëvendësim i ajrit të kondicionuar) 2- Zëvendësimi i llambave inkandeshente me CFL¹ 3- Zëvendësimi i llambave fluoreshente të vjetra me llamba moderne T5² me çakëll elektronike 4- Sisteme termike diellore për ujë të ngrohtë sanitar 5- Ndërrimi i sistemit të ngrohjes konvencionale me pompë ngrohje 6- Instalimi i rrjetit të sistemit fotovoltaik³ 7- Izolimi i mureve të jashtme dhe kulmeve 8- Zëvendësimi i dritareve 9- Zëvendësimi i dyerve të jashtme 10- Ndërrimi i pompave të parregullta për sistemin e ngrohjes qendrore me pompa elektronike të reja të rregulluara 11- Instalimi i radiatorëve tjerë në kombinim me instalimin e valvulave termostatike 12- Shërbimet energjetike dhe bizneset e furnizimit 13- Blerja e pajisjeve elektroshtëpiake me etiketën e EU <p>Kredia mund të jetë e kolateralizuar ose e pa-kolateralizuar.</p> <p>I- Në rastin e kredive me kolateral, banka do të kërkojë si garanci, bllokimin e një pasurie të paluajtshme. Raporti i vlerësimit për pasurinë e paluajtshme kryhet nga vlerësues të pavarur të autorizuar nga banka dhe kjo kosto mbulohet nga</p>

¹ Llambë kompakte floreshente

² Llambë fluoreshente lineare me një diametër prej 5 1/8ths e një inç (rreth 16mm)

³ Panele diellore që konvertojnë rrezet e diellit në energji elektrike

	<p>aplikanti. Në çdo rast vlera imediate e likuidimit të pasurisë do të jetë minimum 120% e vlerës së kredisë së akorduar dhe vlera e tregut do të jetë minimumi 150% e kredisë së aprovuar. Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste të barabarta mujore (kryegjë + interes) sipas aneksit të shlyerjes dhe jo si shlyrje e njehershme në fund të afatit të maturimit.</p> <p>II- Në rastin kur kredia është e pa-kolateralizuar mund të aplikojnë vetëm individë të cilët kanë të ardhura nga paga, qeraja apo aktiviteti si te vetëpunësuar. Banka do të kërkojë si garanci dorëzaninë sipas rasteve më poshtë:</p> <p>1. Klientë që tërheqin pagën dhe/ose qeranë nëpërmjet BKT dhe/ose Profesionistët e vetëpunësuar: Për kredi deri në 250,000 Lek – nuk kërkohet garanci / dorëzani Për kredi nga 250,001 Lek deri në 500,000 Lek - 1 dorezanës (nëse është i martuar bashkëshorti/ja, nëse jo një person tjetër i pranueshëm nga banka) Për kredi nga 500,001 Lek deri në 1,000,000 Lek - 2 dorëzanës (nëse është i martuar njëri nga dorëzanësit do jetë bashkëshorti/ja dhe një person tjetër i pranueshëm nga banka).</p> <p>2. Klientë të tjerë: -Nëse është i martuar njëri nga dorëzanësit do jetë bashkëshorti/ja dhe një person tjetër i pranueshëm nga banka -Dy dorezanës të pranueshëm nga banka në rast se klienti nuk është i martuar Në çdo rast do të kërkohet dorëzania e dy personave.</p>
<p>6. Norma e interesit (tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar)</p>	<p>I. Kredi e Gjellbër me Kolateral Në Lek 3.5% per 24 muajt e pare, me pas B-Thesari 2.5% (jo me pak se 4.5% pas 24 muajsh) Ose B.Th 1vj+2.2% (jo më pak se 4.5%, pas kështit të 24-t).</p> <p>Në Euro: Euribor 1Y +4% (jo më pak se 4%)</p> <p>Norma e ofruar e interesit është e ndryshueshme sipas luhatjeve të Bonove të Thesarit, me afat 1-vjeçar, çdo 12 muaj të kredisë. Aplikanti do të informohet nëpërmjet telefonit, postës elektronike ose me postë për çdo ndryshim në kushtet dhe termat e kontratës së kredisë.</p> <p><i>Për Kredinë e Gjellbër me Kolateral klienti mund të zgjedhë të bëjë ose jo sigurimin e jetës. Në rastin e dytë ai do të pranojë normë më të lartë interesi sipas opsioneve të mëposhtme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në qoftë se klienti është deri në 45 vjeç, norma e interesit do të jetë 0.5% më e lartë se ajo standarde. - Në qoftë se klienti është mbi 45 vjeç, norma e interesit do të jetë 1% më e lartë se ajo standarde. <p><i>Në këto raste normat do të ndryshojnë respektivisht:</i></p>

	<p>Në: - B. Th 1Vj +2.7% (jo më pak se 5% pas këstit të 24-t)</p> <p>Ose - B. Th 1Vj +3.2% (jo më pak se 5.5% pas këstit të 24-t)</p> <p>II. Kredi e Gjelbër pa Kolateral</p> <p>- Klientë që tërheqin pagën dhe/ose qeranë nëpërmjet BKT dhe/ose Profesionistët e vetëpunësuar: 5.5% për 12 muajt e parë, më pas B. Th 1-vjeçare + 8% (jo më pak se 10%)</p> <p>Klientë të tjerë: Interesi i aplikuar për këtë kategori do të jetë 1% më i lartë se interesi i përmendur më lartë.</p> <p>Norma e ofruar e interesit është fikse për vitin e parë të kredisë dhe më pas do të jetë e ndryshueshme sipas formulës së përcaktuar për secilën kategori, çdo 12 muaj të kredisë.</p> <p>Aplikanti do të informohet nëpërmjet telefonit, postës elektronike ose me postë për cdo ndryshim në kushtet dhe termat e kontratës së kredisë.</p>				
<p>7. Norma efektive e interesit</p>	<p>Norma efektive e interesit (NEI) shpreh totalin e kostos së kredisë duke përfshirë dhe interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që kredimarrësi paguan në lidhje me kontratën e kredisë. Për qëllime të llogaritjes së NEI totali i kostos së kredisë nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes së NEI, shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në kontratë, kostot e pagueshme nga kredimarrësi lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, tarifat noteriale, tarifat e Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, tarifat e Regjistrimit të Barrëve Siguruese, të përcaktuara sipas akteve përkatëse) dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë; shpenzimet për siguracionin dhe/ose garancitë që nuk janë të detyrueshme, shpenzime për komisione të aplikuara për fondet e papërdorura dhe shpenzime komisionesh për ndryshim të kushteve kontraktore. NEI do të llogaritet me supozimin që :</p> <ul style="list-style-type: none"> - kontrata kredisë është e vlefshme për periudhen e rënë dakord, dhe - palët plotësojnë detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe datës së rënë dakord në kontratën e kredisë, dhe - përqindjet e interesit dhe shpenzimet e tjera që përfshihen në llogaritjen e NEI mbeten të pandryshuara deri në fund të kontratës së kredisë. <p>Klienti do të informohet për vlerën e përafërt të NEI në momentin e aplikimit dhe gjithashtu për vlerën ekzakte në disbursimin e fondeve (me Aneksin e Planit të Pagesës).</p> <p>Pas disbursimit të kredisë aplikanti do të pajiset me aneksin e planit të pagesës në të cilën është shprehur në % Norma Efektive e Interesit (NEI) e cila i referohet vlerës së normës bazë (Bono Thesari 1 vjeçare) sipas kushteve të tregut në momentin në të cilin realizohet disbursimi i kredisë.</p>				
<p>8. Vlera e kredisë dhe monedha e ofruar</p>	<p>Shuma maksimale :</p> <table border="1" data-bbox="416 1921 1562 2016"> <tr> <td data-bbox="416 1921 986 1955">1. Kredi me kolateral</td> <td data-bbox="986 1921 1562 1955">2. Kredi pa kolateral</td> </tr> <tr> <td data-bbox="416 1955 986 1989">Deri në 6.000.000 Lek ose 50.000 Euro</td> <td data-bbox="986 1955 1562 1989">Deri në 1,000,000 Lek</td> </tr> </table>	1. Kredi me kolateral	2. Kredi pa kolateral	Deri në 6.000.000 Lek ose 50.000 Euro	Deri në 1,000,000 Lek
1. Kredi me kolateral	2. Kredi pa kolateral				
Deri në 6.000.000 Lek ose 50.000 Euro	Deri në 1,000,000 Lek				

9. Kohëzgjatja e kontratës së kredisë së gjelbër	Kohëzgjatja Maksimale:	
10. Çelja dhe Levrimi i Kredisë	1. Kredi me kolateral	2. Kredi pa kolateral
	Deri në 180 muaj	Deri në 84 muaj
	<ul style="list-style-type: none"> - Si kusht për lëvrimin e kredisë, Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari rrjedhëse pranë Bankës Kombetare Tregtare, e quajtur "llogaria e kredisë", në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi kredisë. - Tërheqja e kredisë do të bëhet në një nga mënyrat: me anë të tërheqjes në të holla, me anë të tërheqjes me mjete elektronike, me anë të një çeku të lëshuar nga vetë klienti mbi bankën, me anë të urdhër-pagesës së dhënë me shkrim në favor të të tretëve. - Kur gjatë disbursimit Banka konstaton se Kredimarrësi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e Kredisë nënshkruar nga palët, Banka ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate që do të shoqërohet me kthimin e shumave të përdorura deri në atë moment dhe interesin përkatës. 	
11. Numri dhe frekuenca e pagesave	Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste mujore të barabarta. Numri total i kësteve varet nga afati i maturimit.	
12. Vlera e çdo kësti për shlyerjen e kredisë së gjelbër	Kësti = Shuma e kryegjës + shumën e interesit	

Termet e kredisë dhe tabela për llogaritjen e NEI

Shuma e kredisë	2,000,000	Lek
Afati i kredisë	25	Muaj
Komisioni i Disbursimit	1	%
Mosha e Klientit	45	Vjeç
Me Sigurim Jete	Jo	
Primi i Sigurimit të Jetës (~ 0.45%-0.65% e shumës së kredisë)	20,000	Lek
Primi i Sigurimit të Pronës (~ 0.07%-0.15% e shumës së kredisë)	30,000	Lek
Norma Bazë (Bono Thesari 1 vjeçare)	2.00	%
Marzhi	2.20	%
Norma e Interesit deri në këstin e 24-t (e ndryshueshme çdo 12 muaj të kredisë sipas Normë Bazë+Marzh)	4.20	%
Norma e Interesit pas këstit të 24-t*	5.00	%
Kësti (në 12 muajt e parë)	83,690.86	Lek
Kësti (pas këstit të 24t)*	83,746.46	Lek
Vlera Totale për të paguar në fund të periudhës (Kryegjë+Interes)	2,092,327.21	Lek
Norma Efektive e Interesit (NEI)	7.57	%

* Përlllogaritja e normës së interesit pas këstit të 24-t i referohet normës bazë që është në fuqi në muajin aktual

Tabela e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve)

Muaji	Balanca Fillestare	Shuma e interesit	Ripagimi i kryegjësë	Kësti Mujor i Kredisë	Balanca Përfundimtare
1	2,000,000.00	7,000.00	76,690.86	83,690.86	1,923,309.14
2	1,923,309.14	6,731.58	76,959.28	83,690.86	1,846,349.85
3	1,846,349.85	6,462.22	77,228.64	83,690.86	1,769,121.21
4	1,769,121.21	6,191.92	77,498.94	83,690.86	1,691,622.27
5	1,691,622.27	5,920.68	77,770.19	83,690.86	1,613,852.09
6	1,613,852.09	5,648.48	78,042.38	83,690.86	1,535,809.70
7	1,535,809.70	5,375.33	78,315.53	83,690.86	1,457,494.17
8	1,457,494.17	5,101.23	78,589.63	83,690.86	1,378,904.54
9	1,378,904.54	4,826.17	78,864.70	83,690.86	1,300,039.84
10	1,300,039.84	4,550.14	79,140.73	83,690.86	1,220,899.11
11	1,220,899.11	4,273.15	79,417.72	83,690.86	1,141,481.40
12	1,141,481.40	3,995.18	79,695.68	83,690.86	1,061,785.72

Frekuenca e rishikimit të normës bazë të interesit në këtë rast Bono Thesari bëhet çdo 12 muaj të kredisë, pra në çdo rast rishikimi i normës së interesit do të bëhet në datën e kesteve që janë shumëfisha të 12-ës deri në maturimin e kredisë.

Kjo është një tabelë ilustruese dhe përlllogaritja e kesteve pas këstit te 24-t (kur hyn në fuqi minimumi i normës së interesit) i referohet normës bazë të interesit që është në fuqi në muajin aktual.

13.1. Tabela ilustruese e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve) për Kredinë e Gjelbër me Kolateral

Termet e kredisë dhe tabela për llogaritjen e NEI

Tipi i klientit*	Jo Pagamarrës	
Shuma e kredisë	75,000	Lek
Afati i kredisë	24	Muaj
Norma Bazë (Bono thesari 1 vjecare)	1	%
Komisioni i Disbursimit	2.50	%
Norma e Interesit në 12 muajt e parë (fikse)	6.5	%
Norma e Interesit pas 12 muajve të parë (e ndryshueshme çdo 12 muaj sipas Normë Bazë+Marzh)	11	%
Kësti (në 12 muajt e parë)	3,340.97	Lek
Kësti (pas 12 muajve të parë)	3,421.70	Lek
Vlera Totale për të paguar në fund të periudhës (Kryegjë+Interes)	81,152.01	Lek
Norma Efektive e Interesit (NEI)	10.15	%

13.2 Tabela ilustruese e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve) për Kredinë e Gjellbër pa Kolateral

Tabela e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve)

Muaji	Balanca Fillestare	Shuma e interesit	Ripagimi i kryegjësë	Kësti Mujor i Kredisë	Balanca Përfundimtare
1	75,000.00	406.25	2,934.72	3,340.97	72,065.28
2	72,065.28	390.35	2,950.62	3,340.97	69,114.67
3	69,114.67	374.37	2,966.60	3,340.97	66,148.07
4	66,148.07	358.30	2,982.67	3,340.97	63,165.40
5	63,165.40	342.15	2,998.82	3,340.97	60,166.58
6	60,166.58	325.90	3,015.07	3,340.97	57,151.51
7	57,151.51	309.57	3,031.40	3,340.97	54,120.11
8	54,120.11	293.15	3,047.82	3,340.97	51,072.30
9	51,072.30	276.64	3,064.33	3,340.97	48,007.97
10	48,007.97	260.04	3,080.93	3,340.97	44,927.04
11	44,927.04	243.35	3,097.61	3,340.97	41,829.43
12	41,829.43	226.58	3,114.39	3,340.97	38,715.04

* Termi "Pagamarrës" i referohet edhe klientëve që kanë të ardhura nga qeraja dhe që e tërheqin atë nëpërmjet BKT gjithashtu edhe klientëve profesionistë të vetëpunësuar (si p.sh: doktorë, noterë, avokatë, farmacistë, kontabilistë).

Kjo është një tabelë ilustruese dhe përlllogaritja e kësteve pas 12 muajve të parë të kredisë i referohet normës bazë të interesit që është në fuqi në muajin aktual.

14. Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin kur aplikohen të tilla

- Kredi me kolateral:** Shpenzime për raportin e vlerësimit të pasurisë (varion nga 7,500 Lek - 30,000 Lek në bazë të llojit të pasurisë objekt vlerësimi). Kosto e përmendur më lartë klasifikohet si kosto para aprovimit dhe mbulohet nga aplikanti, pavarësisht vendimit përfundimtar. Kjo kosto është e pashmangshme nga aplikanti. Ky shërbim nuk ofrohet nga banka por nga ekspertë të autorizuar.
- Kredi pa kolateral:** Nuk ka.

15. Kosto shtesë të tjera

Lloji i shpenzimit	1. Kredi me kolateral	2. Kredi pa kolateral
Shpenzime noteriale	~ 3,800 ALL/ për Kontratë Kredie dhe ~2,600 – 7,400ALL për Kontratë Hipotekore	NUK KA
Primi i policës të sigurimit të jetës	~ 0.45%-0.65% e shumës së kredisë (Varion nga shuma e	NUK KA

		kredisë, mosha dhe gjinia e aplikantit)	
	Shpenzimet e hipotekës	Për shuma kredie nga 1,000,001 Lek deri në 10,000,000 Lek ~ 15,000 Lek Për shuma kredie mbi 10,000,000 Lek ~ 25,000 Lek	NUK KA
	Primi i policës së sigurimit të kolateralit	~ 0.07%-0.15% e shumës së kredisë (Varion nga shuma e kredisë, lloj i pronës dhe vendndodhja e saj, etj.)	NUK KA
	Komision disbursimi	- 1 % mbi Shumën e kredisë - 0% për blerje kredie nga banka të tjera (vetëm në rastet kur kontrata e kredisë që po blihet ka komision për mbyllje para afatit).	- 2.5% e shumës së kredisë (jo më pak se 1,500 Lek) për kredi me afat deri në 36 muaj) - 2% e shumës së kredisë (jo më pak se 1,500 Lek) për kredi me afat mbi 36 muaj) - 0% për blerje kredie nga banka të tjera (vetëm në rastet kur kontrata e kredisë që po blihet ka komision për mbyllje para afatit).
	<p>Kostot e mësipërme klasifikohen si kosto pas miratimit të kredisë. Këto shpenzime janë të pashmangshme dhe të detyrueshme para disbursimit të kredisë. Shpenzimet e hipotekimit, noterizimet e kontratave të kredisë dhe komisioni i angazhimit ekzekutohen vetëm një herë, ndërsa primet e policave të sigurimit të pronës dhe jetës përsëriten çdo vit.</p>		
16. Shlyerja para afatit të maturimit (kur është e aplikueshme)	<p>1. Kredi me kolateral: - 2% të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit. - 1% të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë nuk kalon 1 vit.</p> <p>2. Kredi pa kolateral: Banka do të pranojë mbyllje të parakohshme të huasë, të pjesëshme (jo më pak se vlera e një kësti kredie) apo totale të principalit të kredisë, me kusht që kredimarrësi të paguajë të gjitha interesat e rradhës plus një interes 1(një) ditor, si dhe pagimin e një kostoje operative ekstra në masën 1(një) % mbi shumën e parapaguar të principalit të huasë nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit dhe 0.5% (zero pikë pesë) mbi shumën e parapaguar të principalit huasë nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është nën 1 vit, për rastet kur mbyllja e parakohshme bëhet gjatë periudhës kur interesi i kredisë është i pandryshueshëm.</p>		

	<p>Në rastet kur mbyllja e parakohshme e kredisë bëhet gjatë periudhës kur interesi i kredisë është I ndryshueshëm, Banka do të pranojë mbyllje të parakohshme të huasë, me kusht që kredimarrësi të paguajë të gjitha interesat e rradhës plus një interes 1(një) ditor.</p>
<p>17. Njoftimi zyrtar midis paleve</p>	<p>Të gjithë njoftimet, komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë të regjistruar (rekomande) në adresën e përcaktuar në Kontratën e Kredisë, ose kur është e mundshme me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (e-mail të përcaktuar në Kontratën e Kredisë, disketë, CD-ROM, DVD, Kuti Postare).</p> <p>Kredimarrësi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në adresat e deklaruara do të konsiderohen si të marra nga ai. Kredimarrësi mund t'i paraqesë Bankës reklamimet e tij, për sa njoftohet, brenda një afati prej 15 ditësh kalendarike.</p> <p>Kredimarrësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 diteve kalendarike për këtë ndryshim. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme.</p>
<p>18. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë</p>	<p>1. Kredi me kolateral: Kredimarrësi ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e Kredisë brenda një periudhe kalendarike 7 ditore. Ky afat fillon nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në rastet kur shuma e kredisë është disbursuar në llogarinë e Kredimarrësit dhe ky i fundit ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë, atëherë kredimarrësi pranon dhe merr përsipër të shlyejë kryegjënë dhe gjithë detyrimet për interesa dhe /ose penalitete, si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj shume. Nëse kredimarrësi tërhiqet nga kontrata e kredisë, edhe bashkëkredimarrësi ose dorëzanësi apo hipotekuesi apo garancidhënësi që ka dhënë garanci për detyrimet e kredimarrësit sipas kësaj kontrate, gjithashtu, tërhiqet nga kontrata e kredisë ose tërheq garancinë/të e vendosura prej tij për ekzekutimin e kontratës.</p> <p>2. Kredi pa kolateral: Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e Kredisë brenda një periudhe kalendarike 14 ditore. Ky afat fillon nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në rastet kur shuma e kredise është disbursuar në llogarinë e klientit dhe ky i fundit ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë, atëherë klienti pranon dhe merr përsipër të shlyejë kryegjënë dhe gjithë detyrimet për interesa dhe /ose penalitete, si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj shume. Nëse kredimarrësi tërhiqet nga kontrata e kredisë, edhe bashkëkredimarrësi ose dorëzanësi gjithashtu, tërhiqet nga kontrata e kredisë ose tërheq garancinë/të e vendosura prej tij për ekzekutimin e kontratës.</p>
<p>19. Skemat e brendshme të ankimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ankesë me shkrim pranë çdo dege - Vizitë pranë çdo dege - Nëpërmjet telefonit (+355 42 266 288) call center - Nëpërmjet adresës elektronike info@bkt.com.al
<p>20. Penalitete të tjera</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në rast se Banka zbulon që kredia nuk është përdorur për qëllimin e akorduar, atëherë ajo ka të drejtë që të kërkojë menjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluar, ose në rast se e gjykon të arsyeshme në vend të aplikimit të veprimit të sipërpërmendur, mund të aplikojë 1% penalitet mbi shumën fillestare të kredisë. - Në rast të mospagimit të komisioneve dhe interesit, Banka ka të drejtë të aplikojë një penalitet prej 4(katër)% në Lek, në muaj mbi shumën e papaguar të

	<p>komisionit dhe interesit.</p> <p>- Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar (interesin ose kryegjën), Banka përvec normës së interesit normal, ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën 4(katër)% në Lek në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e këstit të rradhës së pa paguar (kryegjë + interes) për periudhën në të cilën ai është më vonesë në bazë të kushteve të kësaj kontrate</p> <p>Përlllogaritja e penalitetit: Shuma në vonesë x normën e penalitet% x 12 muaj / 360 ditë x ditët në vonesë</p>
<p>21. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor</p>	<p>Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7(shtatë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti.</p>

_____/_____/_____/_____
 (Qyteti, dd,mm,vvvv)

 Klienti: Emër Mbiemër
 (Firma)